

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 436 Prot.

Tiranë, më 30.03 2017

VENDIM Nr. 52, datë 24.03.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5 të datës 24.03.2017, pasi shqyrtoi Konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit "*Godinë 5 kat mbi tokë dhe 1kat nëntokë*", *Lagjia Nr. 1, rruga "Nako Spiro" dhe rruga "De Rada", Durrës, zona arkeologjike "B"*-subjekti "FAKLE" sh.p.k., paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "A.KeR." sh.p.k.

VENDOSI:

1. Të miratojë Konceptin e gërmimit arkeologjik të shpëtimit në kuadër të projektit "*Godinë 5 kat mbi tokë dhe 1kat nëntokë*", *Lagjia Nr. 1, rruga "Nako Spiro" dhe rruga "De Rada", Durrës, zona arkeologjike "B"*-subjekti "FAKLE" sh.p.k., paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "A.KeR." sh.p.k.
2. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje disa palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të realizojë gërmimin e shpëtimit, DRKK Durrës e cila do të monitorojë atë dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik që do të realizojë mbikëqyrjen e këtij procesi.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes disa palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTËR

SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO